



Shkup, 01.03. 2017

Rreth projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare,“

Me qëllim të përmirësimit të mjedisit afarist në Republikën e Maqedonisë, përmes mbylljes së më të shpejtë të shoqërive tregtare përmes procedurave për falimentim dhe likuidim vullnetar, Bashkimi Evropian, me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA), më 20 nëntor 2015 filloi me realizimin e projektit „Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare“. Kohëzgjatja e projektit është 2 vite dhe zbatohet nga ana e konsorciumit të udhëhequr nga Pohl Consulting & Associates, në partneritet me Ernst & Young.

Në këtë pjesë të projektit fokusi do të përqendrohet në harmonizimin e kornizës ekzistuese ligjore për likuidim dhe falimentim dhe përmirësimin e përgjithshëm të tyre, përmes këshillimeve, trajnimeve dhe tryezave të rumbullakëta. Do të bëhen përpjekje që projekti të kontribuojë për përfocimin e aftësisë së vendit për të qenë një destinacion afarist dhe një treg në të cilin shoqëritë tregtare që janë nën falimentim, apo janë insolvente, të dalin shpejtë nga tregu.

Rezultatet e pritura:

1. Përforcimi i kapacitetit institucional në Sektorin për çështje juridike (Departamenti për falimentim dhe privatizim) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe aktorëve relevant kryesorë: Oda e administratorëve të falimentimit dhe Regjistri Qendror.

Propozimi për riorganizim të Departamentit për falimentim dhe privatizim në kuadër të Sektorit për çështje juridike do të rezultojë me Sektor për falimentim me dy departamente të cilat do të funksionojnë në mënyrë më efektive dhe do të sigurojnë rezultate cilësore. Të punësuarit do t'i përmirësojnë aftësitë e tyre përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe bartjes së njohurive për zbatimin efikas të detyrave të tyre të cilat dalin prej kornizës ligjore për falimentim.

2. Shqyrtimi i funksioneve dhe dispozitave ligjore në kornizën ekzistuese për falimentim dhe sigurimi i rekomandimeve për përmirësim

Rekomandimet për përpunjen dhe harmonizimin legjislativ të kornizës ligjore për procedurat për falimentim me praktikën më të mirë të vendeve - anëtare të BE-së do të jenë rezultati kryesor i projektit, ndërsa nga ligdhënësi vendor pritet zbatimi i tyre i mëtejshëm. Kjo pjesë e projektit do të bazohet në vlerësimin e mangësive, rekomandimeve për mënjanimin e tyre, trajnimeve për zbatimin e praktikave më të mira dhe tryezave të rumbullakëta me aktorët relevant për vendosjen e konsensusit lidhur me zbatimin e domosdoshëm dhe përmirësimet legjislative.

3. Shqyrtimi i funksioneve dhe dispozitave ligjore në kornizën ekzistuese për likuidim dhe sigurimi i rekomandimeve për përmirësim

Rekomandimet për përpunjen dhe harmonizimin legjislativ të kornizës ligjore për procedurat për falimentim me praktikën më të mirë të vendeve - anëtare të BE-së do të jenë rezultati kryesor i projektit, ndërsa nga ligdhënësi vendor pritet zbatimi i tyre i mëtejshëm. Kjo pjesë e projektit do të përqendrohet në harmonizimin e procesit të likuidimit dhe përmirësimin e tij në përgjithësi, si dhe në zhvillimin e procedurës ekzistuese për fshirjen e kompanive joaktive nga Regjistri tregtar. Gjithashtu, gjatë zbatimit të projektit janë paraparë edhe trajnime për zbatimin e praktikave më të mira dhe tryeza të rumbullakëta me aktorët relevant.